

FJALA E DEPUTETES GRETA BARDELI

E HËNË 6 QERSHOR 2022

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Kam tri çështje për të sjellë në vëmendjen e këtij parlamenti. Këto tri çështje lidhen me qarkun që unë përfaqësoj, Shkodrën, komunitetin dhe sakrificën e tyre të përditshme. Së pari, banorët e Dukagjinit më kanë ngritur çështjen e mungesës së energjisë elektrike herë pas here gjatë ditës. Këtu përfshihet edhe Bregu i Lumit dhe Thethi, që aktualisht janë plot me turistë vendas dhe të huaj, që e vizitojnë këtë vend jo vetëm për bukuritë turistike, por edhe për dobitë shëndetësore dhe kurative që ofrojnë këto bjeshkë. Pas një dimri të vështirë me plot pengesa është e drejta e tyre të kenë të garantuar atë që u takon ngashteti.

Mungesa e energjisë elektrike veçanërisht në orët e mbrëmjes i kthen banorët e këtyre zonave në kohërat e kaluara ku veç kandili bëhej burimi i dritës. Kërkoj në emër të tyre garantimin e energjisë elektrike për 24 orë. Nuk mund të vazhdojnë të mbajnë ekonomitë e tyre të vogla familjet e tyre, turizmin malor në kushtet e mungesës së energjisë elektrike. Së dyti, i kam kërkuar, në cilësinë e deputetes, Fondit Shqiptar të Zhvillimit informacion për rrugën e malësisë së Dukagjinit kësaj perle të Veriut, por edhe për detyrimin që ka për historinë, traditën, kulturën, besimin dhe dëshminë e forcës dhe kurajën në shekuj. Përgjigjja e drejtorit të Fondit është se vazhdon të jetë në fazën e hartimit të projektit, por unë mendoj se jemi të qartë të gjithë deputetët e veriut që ky projekt duhet të marrë fund sa më shpejt dhe pa diskutim duhet të përfshijë 3 njësitë administrative Pultin, Shoshin dhe Shalën.

Është kërkesë e të gjithë komunitetit, por edhe i ka ardhur koha për të hapur një dritare të re për turizmin kombëtar dhe ndërkombëtar . Së treti, do të ndalem në koncesionin Thumanë-Kashar, një projekt që sipas qeverisë kur të realizohet do të jetë me pagesë për 35 vjet. Të nderuar deputetë, sidomos ju të zonës së Veriut, si ka mundësi të lejohet t'i bëhet gjithë kjo

arrogancë veriut të Shqipërisë dhe zonave të tona, që janë zonat më të varfra. Autostrada Kukës-Milot me pagesë, koncesioni që propozohet Thumanë-Kashar do të bëhet me pagesë, por ju nuk mund ta detyroni vendin dhe sidomos Veriun të paguajë projektin e një qeverie që, sipas meje i ka futur dorën në xhep qytetarëve për të paguar koncesionet e korruptuara. Dhe në këtë rrugë ai nuk ka bërë asnjë investim.

Jam e bindur që do të përballemi me reagimin e qytetarëve për një projekt që duhej të kishte përfunduar tashmë me një parashikim të detyrueshëm financiar, nëse kjo qeveri nuk do të ishte përfshirë në afëra korruptive.